



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

 **metropolitan**  
SH.PAL UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

**KOLEGJI "BIZNESI"**

Nr. 169/17 Data 23.03.2017  
PRISHTINË

**UNIVERSITETI  
METROPOLITAN TIRANA**

Nr. Prot. .... 58 ..... Datë 29/03/2017

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**SHPAL "UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA" TIRANË**

**DHE**

**KOLEGJI "BIZNESI" Prishtinë**

SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana" Tiranë dhe Kolegji "BIZNESI" Prishtinë, më poshtë të quajtura "palë",

të nisur nga dëshira për të vendosur lidhje më të mira bashkëpunimi institucional me interes reciprok si dhe me qëllim disiplinimin e shkëmbimit dhe koordinimit të veprimtarive kërkimore, shkencore, ranë dakord për sa vijon:

#### **Neni 1**

Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në kualifikimet e stafeve akademike të njëra-tjetrës, nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese, projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta, udhëheqjeve shkencore, etj.

#### **Neni 2**

Palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë botime akademike apo periodike si dhe çdo informacion tjetër shkencor me interes të përbashkët.

#### **Neni 3**

Palët do të informojnë njëra-tjetrën për organizimin e konferencave shkencore nga ana e tyre ose në bashkëpunim me fakultete apo institucione homologe, vendase ose të huaja dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e pedagogëve të tyre në këto veprimtari.

#### **Neni 4**

Në kuadrin e shkëmbimit të përvojës pedagogjike dhe akademike, palët do t'i dërgojnë njëra-tjetrës programet dhe planet e tyre mësimore.

#### **Neni 5**

Palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë lektorë për dhënie leksionesh në disiplina që do t'i gjykojnë me interes të përbashkët, duke respektuar aktet e brendshme normative të tyre.

### Neni 6

Pedagogët e të dyja palëve, në varësi të interesit, do të marrin pjesë në veprimtari studimore e akademike të përbashkëta.

### Neni 7

Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive do të realizojnë shkëmbimin e studentëve.

### Neni 8

Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive do të kryejnë shkëmbimin e ambienteve laboratorike dhe didaktike për studentët dhe stafet akademike.

### Neni 9

Palët lidhin partneritet për zhvillimin e projekteve të përbashkëta për programet Erasmus +, IPA, Horizon 2020, etj.

### Neni 10

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për 5 vite akademike, duke filluar nga viti akademik 2017-2018.

Nënshkruar në Tiranë më 29.03.2017 në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**PËR**  
**SHPAL "UNIVERSITETI**  
**METROPOLITAN TIRANA"**

**REKTORI**

Prof. Dr. Agim SELENICA



**PËR**  
**KOLEGJI BIZNESI**

**REKTORI**

Prof. Dr. Shyqeri KABASHI

